



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Komisioni i Konkurrencës zgjat afatin e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 25 Korrik 2025, vendosi të ndryshojë Vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025, që ka të bëjë me hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Ky vendim vjen si rezultat i nevojës për një analizë më të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare si dhe sigurimi për një vendimarrje objektive nga ana e Komisionit të Konkurrencës.

Për këtë arsye, me **Vendimin nr. 1201, datë 25.07.2025**, Komisioni vendosi të ndryshohen pikat II dhe III, në VKK nr. 1156, datë 29.01.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, si vijon:

II. “Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 25.07.2025”.

III. “Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 29 Tetor 2025”.

Për më shumë informacion, ju ftojmë të vizitoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës: www.caa.gov.al.